



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1012 prot.

Shkodër, më 15.01. 2026

**PROJEKTVENDIM
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS DHE DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARES SË
KËSHILLIT BASHKIAK**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të radhës, në mbështetje të nenit 49, pikat 1 dhe 2, nenit 54, shkronja "j", nenit 55, pika 3, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 164 të Kodit Zgjedhor, shkresës nr. 628, datë 09.01.2026, Vendimit nr. 1, datë 06.01.2026, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe relacionit nr. 942 prot., datë 14.01.2026, të Komisionit të Mandateve,

VENDOSI :

1. Plotësimin e vakancës dhe miratimin e dhënies së mandatit të anëtares së Këshillit Bashkiak Shkodër, znj. **Daniela Pavlo Jakoja**, si kandidate nga lista shumëëmërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretaria e Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oliver LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 942 prot.

Shkodër, më 14 . 01 . 2026

Lënda: *Relacion*

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Komisioni i Mandateve i Këshillit Bashkiak Shkodër, sot, më datë 14.01.2026, mori në shqyrtim plotësimin e vakancës në Këshillin Bashkiak Shkodër, me kandidaten nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, znj. Daniela Pavlo Jakoja.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me Vendimin nr. 1, datë 06.01.2026, referuar shkresës nr. 24713 prot., datë 02.12.2025, të Këshillit Bashkiak Shkodër, për krijimin e vakancës nga këshilltarja znj. Bledianë Hasan Nika, ka vendosur plotësimin e vakancës me kandidaten nga lista shumëemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, znj. Daniela Pavlo Jakoja.

Referuar dokumentacionit që disponojmë, nuk rezultojnë kushte papajtueshmërie, sipas ndalimeve të nenit 47 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për sa më sipër, Komisioni, i mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, vlerëson dhe i propozon Këshillit Bashkiak marrjen e vendimit përkatës për dhënien e mandatit të këshilltares znj. **Daniela Pavlo Jakoja**.

KOMISIONI

SEKRETAR

Izmira RUSI

KRYETAR

Uarda GJEKAJ

ANËTAR

Gjovalin NDOJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 8/01/2026

Nr 59

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër ✓
Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1, Shkodër
Partisë Socialiste të Shqipërisë
Sheshi "Austria", Nr. 91, Tiranë
Zj. Daniela Pavlo Jakoja
Rruga "Europa", Shkodër

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 29.12.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Shkodër, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë" zj. Daniela Pavlo Jakoja.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr.1, datë 6.01.2026.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.


Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)



CHIEF, DUTY, SHKËRIM, KERKESA
DATE 9.1.2026
628

INFORMATA E TITULLARIT:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 6.1.2026

Nr: 1

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË, ZJ. DANIELA PAVLO JAKOJA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 24713 prot., datë 02.12.2025, Këshilli i Bashkisë Shkodër, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Bledianë Hasan Nika, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë".


Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Shkodër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 20, zj. Daniela Pavlo Jakoja.

Me shkresën nr.7306, prot., datë 05.12.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, zj. Daniela Pavlo Jakoja, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PS-6033_1

Data: 6.1.2026 Nr:1
Ora: 12:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Daniela Pavlo Jakoja".

unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Daniela Pavlo Jakoja, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 7354 prot., datë 10.12.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7353 prot., datë 10.12.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zj. Daniela Pavlo Jakoja.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Daniela Pavlo Jakoja në Këshillin e Bashkisë Shkodër.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 20321/1 prot., datë 15.12.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Daniela Pavlo Jakoja, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Daniela Pavlo Jakoja, në Këshillin e Bashkisë Shkodër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"


V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Daniela Pavlo Jakoja.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Data: 6.1.2026 Nr.1
Ora: 12:30



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Daniela Pavlo Jakoja".